

VENDIM
Nr. 111, datë 2.3.2022

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHETETËRORE TË
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision hartimin e zbatimit e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e planifikimit dhe të zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës e të transportit, në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, në sektorin e energjisë, të shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare, si dhe në sektorin e industrisë.

3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, në këto fusha:

a) planifikimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm urban;
b) standardet urbane në ndërtim;
c) hartimi, zbatimi dhe ndjekja e politikave të zhvillimit të infrastrukturës, në të cilat përfshihen infrastruktura, transporti dhe ujësjellës-kanalizimet;

ç) drejtimi, menaxhimi, mbikëqyrja dhe vendosja e standardeve teknike të infrastrukturës së rrjeteve rrugore e hekurudhore, të porteve, aeroporteve, ujësjellës-kanalizimeve dhe të digave të mëdha të hidrocentraleve. Përcaktimi dhe vendosja e standardeve për të gjitha llojet e mjeteve të transportit dhe organizimi i drejtimit të kontrollit shtetëror të sigurisë teknike në sferën e shfrytëzimit;

d) monitorimi i realizimit të standardeve të përcaktuara në funksion të zhvillimit të infrastrukturës në transport, ujësjellës-kanalizime, si dhe të punimeve të ndërtimit për zbatimin e rregullave për kontrollin e disiplinimin e tyre në aspektin financiar e teknik;

dh) hartimi dhe zbatimi i monitorimit të trafikut rrugor, detar, ajror dhe hekurudhor përmes sistemeve inteligjente të vendosura në agjencitë, ndërmarrjet dhe drejtoritë e varësisë, për të garantuar sigurinë e çdo sektori të sipërpërmendur, në linjë me parimet ndërkombëtare. Sigurimi i kushteve lehtësuese të të gjithë përdoruesve dhe operatorëve vendës e të huaj nëpërmjet sistemeve inteligjente, të përshtatshme për t’u përfshirë në sistemet evropiane të informacionit;

e) sektori i energjisë, i burimeve energjetike, përfshirë edhe burimet e rinovueshme të energjisë, si dhe efienca e energjisë;

ë) hartimi i politikave dhe strategjitë për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike të ardhura si pasojë e veprimtarisë së fushave të përgjegjësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

f) sektori i hidrokarbureve (naftë dhe gaz);

g) sektori i minierave dhe gjeologjisë;

gj) sektori i industrisë joushqimore;

h) telekomunikacioni dhe shërbimi postar.

4. Vendimi nr. 504, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama